



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:127496

Datë: 11.07.2024

Numri i dokumentit: 05927409

**Pml.nr.417/24**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të pandehurit A. P., nga fshati ..., Komuna e .M, për shkak veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal nga neni 277 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, lidhur me veprat penale: Veprimet përgatitore për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1 nën-par. 1.8 lidhur me nen-par.1.13 të KPRK-së, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, Detyrim nga neni 328 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe veprën penale Deklarimi i rremë nga neni 384 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të pandehurit A. P., avokati Agron Curri, paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.6/23 të datës 16.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN.1.S.nr.117/2024 të datës 06.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 08.07.2024, morri këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të pandehurit A. P., ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.6/23 të datës 16.05.2024 dhe aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti Special PN.1.S.nr.117/2024 të datës 06.06.2024.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti Special PS.nr.6/23 të datës 16.05.2024, të pandehurit A. P., për shkak veprës penale Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal nga neni 277 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, lidhur me veprat penale: Veprimet përgatitore për veprën penale vrasja e rëndë nga neni 173 par.1 nën-par. 1.8 lidhur me nen-

par.1.13 të KPRK-së, Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.3 lidhur me par.1 të KPRK-së, Detyrim nga neni 328 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, si edhe për veprën penale Deklarimi i rremë nga neni 384 par.3 lidhur e par.1 të KPRK-së, i ka vazhduar masën e paraburgimit prej 2 (dy) muajve, ashtu që sipas këtij aktvendimi të pandehurit A. P., paraburgimi i është llogaritur prej datës 16.05.2024 deri më datë 17.07.2024. Të pandehurit në fjalë paraburgimi i është vazhduar konform dispozitës së nenit 190 lidhur me nenin 184 par.1 nën paragrafëve 1.1 e 1.2 pikat: 1.2.1, dhe 1.2.3 të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti Special me aktvendimin PN.1.S.nr.117/2024 të datës 06.06.2024, e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit A. P., dhe ka vërtetuar aktvendimin e shkallës së parë.

Kundër këtyre aktvendimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të pandehurit A. P., avokati Agron Curri nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.1 të KPPRK-së, shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, vendimet e atakuara me kërkesë t'i ndryshoj ashtu që i pandehuri A. P., të lëshohet menjëherë për t'u mbrojtur në liri apo të shqiptohet një masë më e butë ose çështjen t'a kthej në rivendosje.

Prokurori i Shteti të Kosovës, me shkresën KMLP.III.nr.177/2024 e datës 03.07.2024, ka propozuar që kërkesat për mbrojtjen e ligjshmërisë të mbrojtësit të të pandehurit A. P., të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit, shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të dispozitës së nenit 435 par.1 dhe 436 par.1 të KPPK dhe pas vlerësimit të pretendimeve që dalin nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë dhe gjeti se:

Kërkesa e mbrojtësit të pandehurit është e pa bazuar

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë mbrojtësi i të pandehurit A. P., pretendon se gjykata e shkallës së parë me rastin e vazhdimit të paraburgimit ndaj të pandehurit A. është marrë me shkeljen esenciale të dispozitave të procedurës penale, sepse dispozitivi i aktvendimit është kundërthënës me brendinë dhe arsyet që konsiderojmë që janë zbatuar gabimisht për faktin se nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ndërsa arsyet e dhëna janë të pa qarta dhe kontradiktore. Mbrojtja konsideron se vazhdimin e paraburgimit nga baza ligjore e nenit 184 paragrafi 1 pika 1.2 pika 1.2.1 të KPRK-së, për rrezikun e ikjes- arratisjes, nëse ndodhet duke u mbrojtur në liri, është i pa bazuar, pasi që as prokuroria e as gjykata nuk kanë arsyetuar këto konstatime, nuk kanë ofruar ndonjë provë që do të vërtetonte se i mbrojturi i tij në të kaluarën është fshehur, ka ikur apo ka penguar rrjedhën e ndonjë procedure penale, e po ashtu edhe për faktin e mbështetjes vetëm në peshës së veprës penale, se i mbrojturi i tij gjendet në paraburgim tani më shumë se dy vite, respektivisht që nga data 20.06.2022, kur tani më kanë pushuar gjitha kushtet për vazhdimin e paraburgimit.

Po ashtu, mbrojtja konsideron se vazhdimi i paraburgimit edhe nga baza ligjore e rrezikut të përseritjes së veprës penale nga pika 1.2.3 e të njejtit nen, duke marrë parasysh natyrën e veprës penale, rrethanat në të cilat dyshohet se janë krye veprat penale, është i pa qëndrueshëm për faktin se tani më kanë kaluar gadi dy vite nga koha kur dyshohet se janë kryer veprat penale, se i mbrojturi i tij ka sqaruar rrethanat dhe ka shpreh pendimin e tij duke premtuar para gjykatës se nuk do të përserisë veprime të tilla.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mësipërme në kërkesë janë të pabazuara, ngase si gjykata e shkallës së parë po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë dhënë arsye të mjaftueshme për bazat ligjore të vazhdimit të paraburgimit. Nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, rezulton dyshimi i bazuar se i pandehuri ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet me çka edhe është ngrit aktakuzë ndaj tij, andaj edhe vazhdon të ekzistoj kushti ligjore nga neni 184, paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të KPP, për vazhdimin e paraburgimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, po ashtu vlerëson se ka bazë ligjore edhe më tutje për vazhdimin e paraburgimit konform nenit 190 lidhur me nenin 184 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 pika 1.2.1 të KPP, për faktin se ekzistojnë rrethana që tregojnë rrezikun se po të gjendet i pandehuri në liri, i njejtë lehtë mund të ik-arratiset për t'iu shmangur përgjegjësisë penale, duke pasur parasysh peshën e veprave penale për të cilat akuzohet, sanksionin që mund t'i shqiptohet nëse shpallet fajtor si dhe moshës së re, rrethana këto që vazhdimin e paraburgimit e bëjnë të arsyeshëm me qëllim të zbatimit të suksesshëm të procedurës penale në këtë çështje penale.

Po ashtu, kjo Gjykatë vlerëson se ka bazë ligjore për vazhdimin e paraburgimit edhe më tutje ndaj të pandehurit Arianit edhe nga baza ligjore e nenit 190 lidhur me nenin 184 par.1 nënpar.1.2 pika 1.2.3 të KPPK, duke pasur parasysh peshën, mënyrën dhe rrethanat në të cilat dyshohet të jenë kryer veprat penale, përkatësisht rrezikshmërinë dhe dënueshmërinë e lartë të veprave penale, veprimet përgatitore për kryerje të veprës penale vrasje e rëndë, veprës penale detyrimi apo shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm me përdorim të armëve të zjarrit, saktësisht me gjuajtjen me molotov si dhe mjete shpërthyesë apo eksplozive, pastaj karakteristikat personale të të pandehurit në fjalë, i cili kishte pohuar faktin se, disa herë ka qenë i arrestuar dhe është mbajtur nën masën e paraburgimit për vepra penale të ndryshme, e po ashtu edhe këmbëngulësinë e të pandehurit A. P., i cili menjëherë pas daljes në liri për shkak të një vepre tjetër penale, sërish shfaqë gatishmërinë për ndërmarrjen e veprimeve të kundërligjshme me ose për të pandehurit tjerë gjatë muajit qershor 2022, për të realizuar qëllimet e tyre të përbashkëta, rrethana këto që e bëjnë të besueshme se me ndodhjen e të pandehurit në liri, i njejtë mund të përserisë veprat penale, andaj vazhdimi i paraburgimit ndaj tij është më se i nevojshëm me qëllim të rrjedhës normale të procedurës.

Andaj, nga arsyet e mësipërme, kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk ka shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës penale, sepse si gjykata e shkallës së parë e po ashtu edhe ajo e shkallës së dytë kanë bërë vlerësimin dhe arsyetimin e duhur, dhe në bazë të vlerësimit të tillë, kanë nxjerrë aktvendimet duke dhënë edhe arsyet të mjaftueshme, të cilat si të drejta i pranon edhe kjo gjykatë, ndërsa masat tjera të parapara nga neni 171 të KPPK-së, janë të pamjaftueshme për sigurimin e prezencës së të pandehurit në procedurë dhe sigurimin e rrjedhës normale të procedurës penale.

Nga se u parashtrua dhe në kuptim të nenit 437 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË  
Pml.nr.417/2024, më datë 08.07.2024

B. profesional,  
Sherif Krasniqi

Kryetare e kolegjit,  
Mejreme Memaj